



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 2 dhjetor 2013
Nr.ref.:VTK512/13

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rasti Nr. KI17/13

Parashtrues

Bujar Bukoshi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në
Prishtinë,
Ka, Nr. 562/12 të 8 tetorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bujar Bukoshi, me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga z. Besnik R. Berisha, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston vendimin Ka. Nr. 265/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 8 tetorit 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar me 10 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit, Ka. Nr. 265/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i cili e konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi thekson se *“pretendimet kundër tij në aktakuzë janë antikushtetuese, pasi që veprimet dhe vendimi që ka marrë ishin brenda fushëveprimit të kompetencave të ministrit të Shëndetësisë.”*
4. Parashtruesi më tutje kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masën e përkohshme për suspendimin e hetimeve penale kundër tij, derisa Gjykata ta merr vendimin përfundimtar.

Baza ligjore

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe Rregulli 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 shkurt 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 13 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
8. Më 25 shkurt 2013, kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI. 17/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI17/13, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 8 mars 2013, Gjykata Kushtetuese, e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Apelit në Prishtinë, si pasardhëse e Gjykatës së Qarkut në Prishtinës.
10. Më 14 mars 2013, Gjykata Kushtetuese nxori Vendimin Rk 388/13, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme.
11. Më 7 tetor 2013, në përputhshmëri me rregullin 32 të Rregullores së Punës , parashtruesi paraqiti kërkesën për heqje të kërkesës nga lista, duke theksuar se *“në lëndën penale në të cilën z. Bukoshi ishte i përfshirë në cilësinë e personit të akuzuar, Gjykata Themelore në Prishtinë, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në instancën e parë, z. Bukoshi e ka liruar nga të gjitha akuzat e Prokurorisë.”*
[...]

“Andaj, meqenëse tashmë kemi një situatë të re procedurale në çështjen penale kundër z. Bukoshi, për interesin tonë, rezulton të jetë e panevojshme procedimi i mëtutjeshëm i Kërkesës K-117/13”.

12. Më 18 nëntor 2013, në dritën e zhvillimeve të lartpërmendura, Gjyqtarja raportuese i propozoi Kolegjit shqyrtues që të ndërpresë ekzaminimin e mëtejshëm të kërkesës.

Vlerësimi i Gjykatës

13. Për të qenë në gjendje të vendosë se çfarë hapa duhet ndërmarrë pas korrespondencës nga përfaqësuesit e parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 32 të Rregullores së Punës së Gjykatës.

14. Neni 23 i Ligjit përcakton se:

“Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i'u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuarra pavarësisht tërheqjes së palës nga procedure”

15. Rregulli 32 i Rregullores së punës thotë si vijon:

Rregulli 32

Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes

- (1) *Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.*
 - (2) *Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të.*
 - (3) *Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj.*
 - (4) *Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest.*
 - (5) *Sekretariati i njofton me shkrim të gjitha palët për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur përkitazi me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.*
16. Gjykata vëren se nuk ekzistojnë rrethana të veçanta lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës, për çfarë do të ishte i nevojshëm ekzaminimi i mëtejshëm i kërkesës. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka çështje që duhet të vendoset.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 23 të Ligjit dhe rregullin 32, paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores punës, më 18 nëntor 2013 njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani

